REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

# U R DH Ë R

**Nr. 8 , datë 16.1.2024**

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR.114, DATË 11.9.2023, TË KRYEMINISTRIT, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË KRYEMINISTRISË"**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar,

**U R DH Ë R O J:**

Në urdhrin nr.114, datë 11.9.2023, të Kryeministrit, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Skema 1, që përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me skemën me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në skemën 2, që përmendet në pikën 2, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

   a) Në paragrafin 7.1, numri i pozicioneve "këshilltar" të bëhet 5 (pesë) dhe numri i pozicioneve "sekretar" të bëhet 1 (një) dhe numri i punonjësve në këtë paragraf të bëhet 7 (shtatë).

   b) Në ndarjen 12, "Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave", të bëhen këto ndryshime:

      i. Në paragrafin 12.1.1 shkurtohet një pozicion "jurist" dhe numri i punonjësve në këtë paragraf të bëhet 5 (pesë);

      ii. Në paragrafin 12.1.2 shkurtohet një pozicion "koordinator" me klasë page II-1 dhe numri i punonjësve në këtë paragraf të bëhet 4 (katër);

iii. Numri i punonjësve në paragrafin 12.1 të bëhet 10 (dhjetë) veta dhe në ndarjen 12 të bëhet 23 (njëzet e tre) veta.

c) Pas ndarjes 13 të shtohet ndarja 14, me këtë përmbajtje:

| | | |
|---|---|---|
| **"14. Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin** | | **1;** |
| **14.1.Kabineti** | | **5;** |
| Drejtor kabineti | I-3 | 1; |
| Këshilltar | I-4 | 3; |
| Sekretar | | 1.". |

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

# STRUKTURA E KRYEMINISTRISË

SKEMA 1

